

Rrugët deri të punësimit dhe shkollimi në Zvicër

Njoftim për të rritur

A e keni kryer një shkollë në vendin tuaj dhe a jeni duke kërkuar punë në Zvicër? Apo ndoshta dëshironi që në Zvicër të shkolloheni më tutje? Në këtë listë ju mund të gjeni disa informata të rëndësishme, të cilat, si hapa të parë, do t'ju ndihmojnë gjatë kërkimit të punës apo shkollimit të mëtutjeshëm.

„Parlez-vous français?“ „Sprechen Sie Deutsch?“ „Parla italiano?“

Pavarësisht a jeni duke kërkuar punë apo ndoshta dëshironi ta kryeni një shkollim: njëra nga parakushtet më të rëndësishme është njohja e gjuhës përkatëse të vendit.¹ Nëse ju jetoni në vendin ku flitet gjermanishtja: filloni ta mësoni gjuhën letrare gjermane! Kështu fitoni një bazë të mirë, që më vonë do ta kuptoni gjermanishten e Zvicrës apo ndoshta edhe ta flisni. Për një ndihmës punëtor edhe mund të mjaftoj nëse kupton dhe din pakëz të flas njërën nga gjuhët përkatëse të vendit. Mirëpo, nga punëtorët, për herë e më shumë po kërkohet që deri diku të dinë ta lexojnë dhe ta shkruajnë një gjuhë. Ndërsa për një punë më kërkesa të larta, gjuhën duhet ta njohin dukshëm më mirë. Për një shkollim të mëtutjeshëm apo për të studiuar, kërkohet që tekstet e vështira t'i lexojnë, t'i kuptojnë dhe të dinë t'i shkruajnë: varësisht nga qëllimi i shkollimit të tyre, ata duhet të arrijnë nivelin e duhur të njohjes së gjuhës. Për këtë arsye është e rëndësishme që të njoftohen mirë, se cilat kurse të gjuhës janë të nevojshme për qëllimin e juaj.

Përveç kësaj, gjuha nuk është e rëndësishme vetëm për punësim apo shkollim të mëtutjeshëm në Zvicër. Njohja e gjuhës ju nevojitet edhe në situata tjera të jetës: të komunikoni me fqinj, të bëni blerje, të dini të komunikoni me mësuesin e fëmijës tuaj, apo me mjekun; të bëni plotësimin e formularëve, të dini të komunikoni me institucionet etj. Në qoftë se në vitet e ardhshme dëshironi (ose duhet) të punoni, ju, duke e mësuar gjuhën, keni bërë hapin e parë, më të rëndësishëm!

Njoftime mbi kurset e gjuhëve, ju mund të gjeni edhe në internet.² Ndërsa, njoftime të tjera për kurset e gjuhëve, mund t'i merrni edhe në Këshillimoren për Profesione, të cilat janë në faqen e fundit të këtij njoftimi.

Këshillë për kërkim të vendit të punës

Për kërkimin e vendit të punës rol shumë të madh luan njohja e gjuhës, shkollimi paraprak, përvoja profesionale dhe lejeqëndrimi. Poashtu gjendja ekonomike në Zvicër, mund të sjellë vështirësi për ta gjetur një vend pune, posaçërisht nëse ju nuk keni punuar asnjëherë më parë në këtë shtet. Shfrytëzoni në ç'do rast që në Zvicër të fitoni përvojë pune: për shembull ta bëni një praktikë, apo ndonjë punë, edhe pse niveli i shkollimit tuaj është më i lartë. Ndoshta më vonë do ta fitoni një vend pune më të mirë, po në të njëjtën ndërmarrje, apo duke ju falënderuar praktikës së bërë, ju mund ta merrni një certifikatë të mirë pune, me të cilën do të keni gjasa më të mira në konkurimet e tjera! Poashtu edhe puna vullnetare mund të jetë një rast i mirë që të fitoni përvojë dhe të njiheni me njerëz të cilët ndoshta mund t'ju ndihmojnë për të gjetur një vend pune.

Tregojuni të afërmve tuaj, shokëve dhe miqve, që jeni duke kërkuar punë. Ndoshta në ndërmarrjet e tyre, befas mund të ketë një vend të lirë? Apo ndoshta këta shokë njohin ndokënd që dinë për ndonjë ndonjë vend të lirë?

¹ Zvicra ka katër gjuhë zyrtare: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe gjuhën retoromane (Rumantsch grischun)

² Kurse për gjuhë në internet: Gjermanisht: www.berufsberatung.ch/weiterbildung
Frëngjisht: www.orientation.ch/perfectionnement
Italisht: www.orientamento.ch/perfezionamento

Një vend të punës në Zvicër mund ta gjeni përmes shpalljeve, gazetave internetit dhe kontaktit direkt në ndonjë ndërmarrje. Përveq kësaj për vendkërkimin e punës mund t'ju ndihmoj edhe qendra regionale ndërmjetsuese e entit për punësim³.

Njohja- verifikimi i diplomave të huaja

A keni mbaruar në vendin tuaj një shkollim me diplomë, keni marrë një certifikatë apo një dëftesë? Ju keni mundësinë që ta testoni se cilën “vlerë” e ka diploma e juaj në Zvicër.

Për ushtrimin e profesionit me diplomën, të cilën e pranon shteti, atëherë është e nevojshme një njohje-verifikim i kësaj diplome. Te profesionet tjera, të cilat nuk i njeh shteti, qendra kontaktuese shtetore propozon një vërtetim të nivelit tuaj, kështu që, për të punuar në Zvicër nuk ju nevojitet njohja e diplomës së vendit tuaj. Nëse një konkruuese ose konkruesi i kërkohet shkollimi përkatës, e tëra kjo mvarret nga tregu i punës dhe nga punëdhënësi ose punëdhënësjat. Te vërtetimi i një niveli profesional, është fjala për vërtetimin e lëshuar nga Zyra Shtetore për Shkollim Profesional dhe Teknologjik (BBT) dhe shkolla, të cilat i informojnë punëtorët e ardhshëm dhe autoritetet lokale për kategorizimin e diplomës së huaj, përkatësisht dëftesës sipas sistemit shkollor zviceran. Për fat të keq, kjo diplomë nuk u garanton se do të gjeni punë në profesionin tuaj, posaçërisht nëse ju mungon përvoja profesionale në Zvicër.

Mirëpo, ajo është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. Dhe ndoshta mund ta vazhdoni një shkollim të mëtuajtshëm, i cili do t'ju ndihmoj dhe përgatitë për kryerjen e diplomës në Zvicër.

Drejtohuni në zyrën kontaktuese të shtetit⁴ këtu do të mësoni, se si duhet vepruar.

Shkollimi – sistemi i arsimit profesional në Zvicër

Në Zvicër rruga deri te një profesion i caktuar duket krejt ndryshe nga ajo e vendit tuaj. Kështu që, këtu vetëm për numër të vogël të profesioneve duhet bërë shkollën e mesme pastaj Universitetin.

Pjesa dërmuese e të rinjve zviceran, mbas shkollimit të detyruar, e mësojnë një profesion në një shkollë profesionale: Gjatë tri deri katër vite shkollimi, ata bëjnë në njërin anë praktikën në një ndërmarrje, por njëkohësisht vazhdojnë në një shkollë për mësimin teorik.

Zvicra ka 250 profesione të cilat mund të mësohen mbas kryerjes së shkollimit të detyruar.

Mbas përfundimit të këtij shkollimi profesional, për secilin profesion ekzistojnë kurse të llojllojshme dhe mundësi të ndryshme shkollimi të mëtuajtshëm. Informohuni se cila rrugë e shkollimit në Zvicër, ju drejton në profesionin tuaj. Kështu do të keni njohuri se cilat mundësi i keni për shkollimin të mëtejshëm por gjithashtu edhe në cilën profesion mund të kërkoni të shkolloheni. Në broshurën “Çka pas shkollës?”, jepet një pasqyrë shumë e mirë mbi sistemin e shkollimit në Zvicër. Kjo broshurë gjendet në këshillimorën për profesione, e përkthyer në gjuhë të ndryshme dhe sipas rregullores, mund të shikohet dhe të huazohet.

Marrja e diplomës për të rritur

Për të rriturit, ka mundësi të ndryshme, që të vijnë deri te marrja e diplomës. Informohuni në Këshillimorën për profesione.

³ Gjermanisht: Regionales Arbeitsvermittlungszentrum (RAV); www.treffpunkt-arbeit.ch
Frëngjisht: Office régional de placement (ORP); www.espace-emploi.ch
Italisht: Ufficio regionale di collocamento (URC); www.area-lavoro.ch

⁴ Gjermanisht: www.bbt.admin.ch > Deutsch >Anerkennung ausländischer Diplome
Frëngjisht: www.bbt.admin.ch > Français >Reconnaissance de diplômes étrangers
Italisht: www.bbt.admin.ch >Italiano >Riconoscimento dei diplomi esteri
Anglisht: www.bbt.admin.ch > English >Recognition of foreign qualifications

Financimi i një studimi apo shkollimit të mëtutjeshëm

Në qoftë se jeni të interesuar të kryeni një shkollim të mëtutjeshëm apo të studioni, ju duhet të mendoni edhe për financim! Shumica e studentëve në Zvicër janë të ndihmuar nga prindërit, apo krahas studimeve punojnë dhe kështu financojnë shkollimin e mëtutjeshëm apo studimet e veta.

Vetëm me kushte të caktuara, është e mundshme që të fitohet bursa.⁵

Oferta të ndryshme të Këshillimorës për Profesione⁶

Nëse doni të informoheni për rrugën e shkollimit, dhe nëse vërtetë mendoni ta ndërtoni ardhmërinë tuaj profesionale në Zvicër, shkoni dhe vizitoni këshillimoren për profesione.

Në këshillimoren për profesione, ju mund të gjeni informata për të gjitha shkollimet dhe profesionet, aty ka edhe një infotekë. Infoteka funksionon sikurse biblioteka. Në këshillimore keni mundësinë të shkoni gjatë orarit të punës pa paralajmërim, atje informoheni për profesione dhe mundësi të ndryshme të shkollimit dhe mund të huazoni material për informim. Në infotekë gjeni fletushka dhe dokumentacione në lidhje me tema të ndryshme, për shembull adresat e këshillimoreve në regjionin tuaj. Këto dokumentacione mund të merren në gjuhë përkatëse të vendit. Vetëm një numër i vogël prej këtyre informacioneve, janë të përkthyer në gjuhë të tjera!

Në rast se nuk dini të gjendeni vetëm në infotekë, mund të kërkonti që ta keni një këshillim personal me një person kompetent dhe të bisedoni në lidhje me situatën tuaj profesionale (lajmërohu në infotekë ose me telefon).

Kjo bisedë do të drejtohet në gjuhën përkatëse vendore. (për gjuhë tjera simbas kërkesave). Këshillimorja për profesione nuk ndërmjetëson për vende pune, mirëpo aty ju mund të bisedoni me këshilltaren/in në lidhje me mundësitë profesionale, ose kërkimin e ideve të reja apo së bashku të planifikoni një rrugë të drejt për punë ose shkollim.

Rruga drejt shkollimit dhe punësimit në Zvicër, kërkon prej jush shumë durim dhe kohë!

Në këtë drejtim, ju urojmë shumë sukses dhe çdo të mirë.

SDBB | CSFO – 2011

⁵ Informacione lidhur me bursat te Këshillimorja për Profesione ose në internet:

Gjermanisht: berufsberatung.ch >Laufbahn >Tipps für die Laufbahnplanung >Finanzierung der Weiterbildung
Frëngjisht: orientation.ch >Formation >Financer sa formation
Italisht: orientamento.ch >Formazioni >Finanzare la propria formazione

⁶ Secili kanton e ka së paku një Këshillimore për Profesione

Adresat mund të merren në shkollë, në komunën tuaj, apo në internet:

Gjermanisht: www.adressen.sdbb.ch Frëngjisht: www.adresses.csfo.ch Italisht: www.indirizzi.csfo.ch

Këshillimorja për Profesione dhe Qendra Informativë për Profesione ÇIP është shpesh e njohur me një emër të veçantë ose me një shkurtesë:

Gjermanisht: BIZ, Laufbahnzentrum
Frëngjisht: OP, SOPFA, OFPC, COS, OROSP, CIO, OCOSP
Italisht: orientamento, UOSP